



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Agri Bau” të datës 14.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Agri Bau” të datës 14.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Agri Bau ShPK” (tutje “parashtruesi”) me datë 14.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Dekorimet verore, dimërore dhe shënimi i datave me rëndësi - ritender” me nr. të prokurimit 616-24-8967-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1.

Me date 23.05.2025 kemi pranuar dokumentin B47 leter standarde per sqarime tenderi ku ju si AK keni kerkuar sqarime lidhur me marrveshjet per korpa ngritese ne mes kompanise tone Agribau SHPK dhe kompanive; ANEA GROUP SHPK, BLINI CLEANERS SHPK me pyetjen e vetme te juaj si me poshte:

Kjo kontrate –Marrëveshje është e pa qarte sepse kërkesë AK se ka qen qe OE te ofroje deshmi dokumentare;

Deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre.

1. Pyetja jone është a keni pasur Marrëveshje për shfrytëzimin pajisjeve me qira me Operatoret e lartë shënuar ekonomik, apo Kontrate për kryerjen e shërbimeve për nevojat e "Agrui Bau" ?

dhe pergjigjeja jone ne pyetjen e juaj eshte kthyer me date 27.05.2025 ku kemi sqaruar lidhur me kontratat e lartcekura (shih me posht pjesen perfundimtare te pergjigjejes tone si rikapitullim i pergjigjejes)

Pra si rikapitullim i ketyr sqarime:

1. Marrveshjet me kompanite Blini Cleaners SHPK dhe Anesa Group SHPK jan marrveshje per shfrytezim te Shportave ngritise me qera me qmim 20.00 euro per Ore/pune, dhe jan ne perputhje te plote me kerkesen e juaj tek FTD.
2. Shporta ngritese e vendosur ne Kamionin me targa 01-790-ZS ku shikuar kamion me venci, eshte ne perputhje te plote me kerkesen e juaj tek FTD.

Prandaj sipas sqarimit te lartcekur ne kemi dorezuar ne oferten tone 3 pajisje-shporta ngritise ne perputhje te plote me kerkesen e juaj tek FTD

Ma gjeresisht mund ti referoheni pyetjes se dates 23.05.2025 dhe pergjigjejes te dhene nga ana jone me date 27.05.2025 te cilat gjinden ne platformen e e-prokurimit te cilat nuk i ngarkum ne tersi por vetem thelbin e permbajtjes se pyetjes dhe pergjigjejes rreth marrveshjeve per korpat ngritese. Prandaj sipas sqarimit te lart cekur, ju keni kerkuar vetem sqarim lidhur me kontratat dhe nuk keni kerkuar asnje sqarim lidhur me **Regjistrim valid te pajisjeve** ashtu siq e keni cekur ju ne vendim Njoftim mbi vendimin perkatesisht me letren standarde per tenderuesin e eliminuar,me te cilin na keni eliminuar .

Ne si Agribau SHPK ju kemi pergjigjur pyetjeve sqaruese te juaja ne kohe dhe ne menyren e duhur dhe nuk kemi ofruar asnje deshmi tjeter per kamion tjeter apo targa tjera ashtu siq keni dhene arsyetimin e juaj per eliminim te kompanise tone, dhe eshte nje veleresim i gabuar nga ana juaj lidhur me sqarimet tone.

Ua perkujtojte se gjat qasjes ne dokumente zyrtara ua kam shpjeguar se na keni kerkua sqarime per kontrata ndersa na keni eliminuar per diqka tjeter qe nuk ekziston –in egzistente sepse as nuk na keni kerkua sqarim per valeditetin e regjistrimit te automjetit as nuk keni pasur pergjigjeje per te njejtin ,por siq u sqarua gjat qasjes ne dokumente ju per qeshtjen e regjistrimit te kamionit keni kerkua sqarim nga nje OE tjeter ndersa kerkesen per OE tjeter e keni ngatruar me kerkese. dhe sqarimet e dhena nga ana jone ,pra sqarimet e OE tjeter i keni ngatruar duke i marr si te tonat andaj edhe keni konstatua per kamionet e kompanis tjeter se nuk jane ata qe ne i kemi prezentuar me rastin e ofertimit,pra ka ndodhur nje gabim nga ana juaje dhe ne vetem ua sqarojm sepse e kuptoje se edhe gabimet jane njerzore por kerkoje nga ana juaje qe ta shqyrtoni drjte kerkesen dhe ta korrigjoni gabimin duke e aprovuar kerkesen dhe ta ktheni landen ne ri-vleresim.

Sepse pa dashur me perserit per neve u kerkua sqarime per krejt diqka tjeter dhe pyetjet dhe pergjigjejet e dhena nga nje OE tjeter jane marr per baze per eliminimin e kompanis tone edhe pse te njejtat neve farae nuk na ishin bere .

Prandaj ky vendim per eliminim te kompanise tone eshte ne kundersizhtim me ligjin mbi Prokurimin publik pikerisht me nen-in 59-Egzaminimi ,Vlersimi,dhe Krahasimi i Tenderve, si dhe nenin 72 te LPP-se edhe nderlidhen dhe bin ne kundersizhtim me te gjitha dispozitat e theksuara ma lart

Pasi qe ju ne vendimin per eliminim te kompanise Agribau SHPK, veq e keni potencuar qeshtjen e mungeses se deshmiwe dokumentare per regjistrim valid te pajisjeve-kamionave, ne si Agribau SHPK permes kesaj kerkese per Rishqyrtim ju informojm se nuk na keni kerkua dhe jemi te hapur per qfardo informacioni qe ju nevojitet edhe lidhur me Validitetin e regjistrimit te kamionave, mirepo ne jemi te hapur per qfardo informacioni qe ju nevojitet dhe luteni qe pa hezitim na kerkoni informacion dhe qka do qe kerkohet ne do ua sjellim .

Pretendimi nr.2

Ne vendimin e dates 09.06.2025 keni marrur vendim per shperblim me kontrate per OE Te Fatosi SHPK e cila eshte e papergjegjshme ne kete aktivitet te prokurimit per shkak se nuk ka bere zgjatje te Validitetit te Ofertes e po ashtu nuk ka bere Vazhdim te Sigurimit te Tenderit.

Me daten 10.06.2025 ne kemi patur qasje ne dokumente zyrtare ku ju si zyre e prokurimit na keni dhene qasje dhe gjate ekzaminimit te dokumentacionit shihet se validiteti i Ofertes ka qene 120 dite nga data 14.10.2024 deri me date **11.02.2025** ndersa OE "Te Fatosi SHPK" nuk e ka vazhduar validitetin e ofertes ne kohe, por ka bere sqarim se vazhdon validitetin e ofertes nga data 20.05.2025. Do te thote sa ka shkeputje te validitetit te Ofertes prej **11.02.2025 deri me 20.05.2025** total: **99 dite**, e qe kjo eshte ne kundërshtim te plote me ligjin mbi Prokurimin Publik dhe nenin Neni 30 Validiteti i Tenderit e qe nderlidhet direkt me nenin 97 te Rregullores nr 001/2022 per prokurim publik versioni i konsoliduar ,po i permendi vetem nenet qe besoj se per zyrtarin pergjegjes te prokurimit jane te kuptueshme na dashur te sterngarkoje kerkesen edhe me pasojat qe nderlidhen me keto shkelje,duke shpresuar se te njejtat shkelje do te eliminohen me rastin e shqyrtimit te kesaj kerkese ,pasi qe ne si ofertues i pergjegjeshem me qmim ma te lire e kemi vazhduar validitetin dhe sigurimin e tenderit me kohe pa nderprere.

Po ashtu gjate ekzaminimit te dokumentacionit verehet se sigurimi i tenderit ka qene me afat nga **14.10.2024 deri me date 13.03.2025** ndersa OE i shpallur fitues "Te Fatosi SHPK" ka bere Sigurim te Tenderit nga data **19.05.2025** qe do te thote se ka shkeputje te Sigurimit te Tenderit nga data **13.03.2025 deri me date 19.05.2025** total: **68 dite**, do te thote se nuk ka bere vazhdim te sigurimit te tenderit, e qe kjo eshte ne kundërshtim te plote me ligjin mbi Prokurimin Publik perkatsisht nenin 57 dhe nenin Neni 28 Sigurimi i Tenderit dhe nenin Neni 30 Validiteti i Tenderit e qe nderlidhet direkt me nenin 97 te Rregullores nr 001/2022 per prokurim publik versioni i konsoliduar dhe **UDHËZUES Nr. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN**

Pretendimi nr.3

Gjate ekzaminimit te dokumentacionit ne te cilin kemi patur qasje, verehet se keni bere verifikimin e Certifikatave ISO per te dy OE-te mirpo konfirmimin Pozitiv keni marrur vetem per OE Agribau SHPK nga Kompania certifikuese "Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd.

Ndersa sa i perket OE e shpallur fitues ju keni bere kerkese per verifikim tek kompania e njejte **Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd.** e cila nuk eshte leshues i Certifikates per kompanine "Te Fatosi SHPK" me qe rast nuk keni marrur pergjigje pozitive nga kjo kompani, por keni perdorur si arsyetim pergjigjen e dhene nga Kompania certifikuese "Sistema Certifications & Inspections Pvt. Ltd. per Agribau SHPK.

Ky eshte manipulim me deshmite se gjoja keni bere verifikim te Certifikates ISO te kompanise "Te Fatosi SHPK",dhe gjat qasjes ne dokumente na keni ofruar per verifikim konfirmimin per kompanin tone te nesermen ua kam kerkua edhe permes emailit konfirmimin per OE te shpallur fitues po deri me tani nuk na e keni dorezuar .

Po ashtu verehet se nuk ka pasur nje komunikim nga AK me OE "Te Fatosi SHPK" per te kerkuar ta dergoi linkun zyrtar per verifikim te kesaj Certifikate.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

- Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Pas pranimit te pergjigjes ne kerkesen për sqarim, perkitazi me Marrëveshjen – kontratën dhe regjistrimin valid për shfrytëzim te pajisjeve, OE;" Agri Bau" AK - ka konstatuar se OE "Agri bau" nuk ka ofruar dëshmi dokumentare për pajise te cilat i ka paraqitur ne ofertën e tije se kane regjistrim valid dhe i plotesoin kerkesa FDT-së 9.1 dhe 9.2 për automjetet te cilat i ka prezantuar ne Marrëveshje –kontrate: Automjeti 1. VOLSFAGEN-VW kamionët me korpe me dy dyer me targa 01-368-JB në pronësi të ANEA GRUP SH.P.K me targa 01-368-JB, 2. MERSEDES-BENZ kamion me vinç me dy dyer ne pronësi AGRIBAU SH.P.K ME TARGA 01-790-ZS dhe 3. MAN kamion me shportë me dy dyer ne pronësi te BINI CLANERS SH.P.K me targa 01-507-Q1. Bazuar ne dispozitat e LPP-se si dhe kërkesat AK-se te përcaktuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit OE" Agri bau" eliminohet nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit pasi në sqarimet e kërkuara për validitet dhe dëshmitë se i plotesoin kriteret OE "AGRIBAU" SH.P.K te datës 27.05.2025 ka prezantuar automjet krejtësisht tjetër qe është ne kundërshtim me kërkesën e AK-së automjet ky Mercedes – Benz kamion me kran -2 Dyer ne pronësi të " AGRIBAU" SH.P.K.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.